



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports
Kabineti i Ministrimit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr.144/2023

Datë: 11.08.2023

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 08/L -117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh neni 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), si dhe pikën 8 (tetë) të Shtojcës 1 (një) të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-088 për Trashëgimi Kulturor, Rregulloren NR. 11/2022 Për Inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes së Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje, nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi me numër të protokollit 3639/2023 i datës 14.07.2023 i Komisionit Profesional Shqyrtues i kërkesave - propozimeve të reja për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme, aseteve apo përmbajtjeve me forma të shprehjes kulturorë - Kategoria e Trashëgimisë Shpirtërore “Festivalin e Teatrove - Ferizaj”.
2. Obligohet QRK- Ferizaj që asetin sipas pikës 1 të dispozitivitetit të këtij vendimi ta regjistrojë në databazë, t'i japë numrin unik, ta kategorizojë sipas Ligjit në fuqi dhe ta përfshijë në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme në kategorinë e Trashëgimisë Shpirtërore.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Kërkesën për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme të “Festivalit të Teatrove” e ka parashtruar Komuna e Ferizajt, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në shkresën me nr. protokoll 1399/2023/02, të datës 20.03.2023. Propozimi është dërguar nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore (DTK) në MKK për t’u shqyrtuar tutje në Komisionin Profesional Shqyrtues (KPSH) i Muzeut Kombëtar të Kosovës (MKK).

KPSH në MKK e ka dhënë rekomandimin që “Festivali i Teatrove – Ferizaj” të përfshihet në listën e Trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme në kuadër të kategorisë Trashëgimi Shpirtërore.

Komisioni Profesional Shqyrtues i DTK pas shqyrtimit të lëndës, formularit të inventarizimit të punuar nga KPSH i MKK dhe rekomandimit të tij, e rekomandon për përfshirje në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme “Festivalin e Teatrove – Ferizaj” për arsye se i përmban këto vlera:

Vlerë historike

Është themeluar në vitin 1968, gjë që e bënë një prej festivaleve më të vjetra të teatrove që kanë vepruar në Kosovë, dhe për herë të parë është organizuar në vitin 1970;

Vlerë të raritetit

Është një prej festivaleve të vetme të teatrove amatore që janë zhvilluar në Kosovë;

Vlerë artistike

Është festival i cili transmeton origjinalitet të artit të mirëfilltë, dhe transmeton po ashtu zhvillim të artit të mirëfilltë skenik. Festivali i teatrove është shndërruar në një traditë kulturore duke i ruajtur vlerat artistike, rritjen e nivelit të artit teatral përmes konkurrencës dhe inkurajimit të artistëve të rinj për pjesëmarrje;

Vlerë shoqërore

Për arsye se ka qenë një ndër festivalet e vetme teatrore në atë kohë i cili ka qenë i rëndësishëm për jetën kulturore të gjitha komuniteteve;

Vlerë shpirtërore

Përmes festivalit janë transmetuar njohuritë dhe aftësitë midis brezave duke u ofruar komuniteteve ndjenjën e identitetit dhe të vazhdimësisë;

Andaj, nga kjo që u tha si në dispozitivin e këtij vendimi “Festivali i Teatrove - Ferizaj” listohet në kategorinë e trashëgimisë shpirtërore me status të mbrojtjes së përkohshme.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit Shqyrtues;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK - Ferizaj;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së.

